



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 17.03.2025
Numër protokoli: 1753/2025

A.nr. 203/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.203/2025, të datës 24.01.2025, të parashtruar nga ankuesi B.H, kundër organit të punësimit: Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 17.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.203/2025, të datës 24.01.2025, të parashtruar nga ankuesi, B.H

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, B.H (në tekstin e mëtejme referuar Ankuesi), më datë 24.01.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me procedurën e rekrutimit me numër reference RN00015132, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, respektivisht për pozitën e punës “*Inspektor i Punës*” – Divizioni i Koordinimeve në Rajonin e Prishtinës, të shpallur nga Inspektorati i Punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.203/2025, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Inspektorati i Punës më datë 13.09.2024, ka shpallur konkursin me Nr. referencës RN00015132, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm,

pozita Inspektor i Punës, në Divizionin e Koordinimeve në Rajonin e Prishtinës , klasa profesional 1, numri i kërkuar 21 vende, me afat aplikimi 14.09.2024 deri 13.10.2024.

Tutje sipas provave materiale të çështjes del së në konkursin përkatës të punësimit ka aplikuar edhe ankuesi, ndërsa të njëjtit me vendimin e datës 21.10.2024 i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se nuk ka dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucionin publik .

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Inspektoratit të Punës, më datë 24.12.2024 ka publikuar njoftimin me numër protokollit 3374/24, nga i cili njoftim, rezulton se procedura e rekrutimit me Nr. referencës RN00015132 ka përfunduar me shtatëmbëdhjetë (17) kandidatë të suksesshëm, më pikë të përgjithshme, si vijon: K.S me 96.8 pikë, U.K.H me 91.4 pikë, D.I me 90.4 pikë, K.TH me 82 pikë, S.LL me 80.2 pikë, G.P me 79.2 pikë, S.M me 78.8 pikë, M.T me 78.4 pikë, A.F me 78.2 pikë , V.M.R 77.6 pikë, I.F 76.4 pikë, SH.K 6 pikë, V.B 74.2 pikë, V.S.L 73.6 pikë, B.S 73 pikë, M.A 72.4 pikë, dhe F.SH 72.2 pikë.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se i ka bashkangjitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në Konkursin me Nr. referencës RN00015132,. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar, si dhe ta anulojë Konkursin me Nr. referencës RN00015132,.

Bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezulton se kandidatja , Drita Bogaj, si kandidate aplikuese në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00015132, më datë 30.12.2024 kishte parashtruar ankesë në Këshill, kundër procedurës së njëjtë pranimit, ndërsa, Këshilli me Vendimin me numër A.nr.2124/2024, të datës 28.02.2025, ka anuluar Konkursin me numër reference RN00015132, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, gjegjësisht pozitën “Inspektor i Punës” – Divizioni i Koordinimeve në Rajonin e Prishtinës, si dhe çdo veprim tjetër që ka rrjedhë nga kjo procedurë e rekrutimit.

Andaj, referuar gjendjes se fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.203/2025, të datës 24.01.2025, ka të bëjë me kontestimin e procedurës së njëjtë të pranimit, për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.2124/2024, të datës 28.02.2025, rrjedhimisht ka anuluar në tërësi procedurën e pranimit me numër reference RN00015132, në tërësi, atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”*, Kolegji vlerëson se objekti i ankesës A.nr.203/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.203/2025, të datës 24.01.2025.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.203/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegji

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit B.H.
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.